



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 415/1 Prot.

Tiranë, më 3.10.2023

**URDHËR**

Nr. 135 Datë 3.10.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PERIUdhËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARIN A1Z PËR MSH 2023**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave, Nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.739, datë 15.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.16, datë 26.07.2023, “Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2023 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023”, të shkresës Nr. 6182, prot., 03.10.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”,

**U R D H Ë R O J:**

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin A1Z, për MSH 2023, **në datën 04 tetor 2023, ora 09.00 – 14.00.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Aurora Balliu

